

SHËNIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 15

Plotesimi i të dhënave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 15. Rradha e dhënies së shpjegimeve duhet të jetë:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabël i aplikuar : Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.(SKK 15)
- 3 Baza e përgatitjes së PF : Mbi bazën e konceptit të materialitetit.(SKK 15)
- 4 Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare: (SKK 15)

1. NJESIA EKONOMIKE Majlinda Gjini PF ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta.

2. VIJIMESIA e veprimtarisë ekonomike të njesisë sone raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.

3. KOMPENSIMI: midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.

4. KUPTUESHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

5. MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zera materiale.

6. BESUESHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhteme :

- Parimin e paraqitjes me besnikëri
- Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
- Parimin e përafërshmerisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
- Parimin e maturisë pa optimizim të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
- Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të PF.
- Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabel
- Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Për përcaktimin e kostos së inventareve është përdorur metoda e mesatares së ponderuar.

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto.

Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, koston e huamarrjes (dhe interesat) është metoda e kapitalizimit në koston e aktivit për periudhën e investimit.

Për vlerësimin e mëposhtem të AAM është zgjedhur modeli i kostonë duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar.

Për llogaritjen e amortizimit të AAM njesia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të A.A.M. metodën e amortizimit mbi bazën e vlefes së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëllojta me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht :

- Për ndertesat me 5 % të vlefes së mbetur.
- Kompjuterat e sistemeve informacioni me 25 % të vlefes së mbetur
- Të gjitha AAM të tjera me 20 % të vlefes së mbetur

Për llogaritjen e amortizimit të AAJM njesia ekonomike raportuese ka përcaktuar si metode të amortizimit ato lineare me normën e amortizimit 15 % në vit.

ADMINISTRATORI
ROBERT DUSHI

